



MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT

NDËRMJET

KOMUNËS SË DRENASIT

dhe

KOMPANISË “AL TRADE CENTER”, nga DRENASI

Datë: 24.02.2022

Nr.prot. DA.400-8501

Duke pasur parasysh që Kompania “ALTRADE CENTER” me seli në Drenas që disa vite ka ndarë bursa për studentët e Komunës së Drenasit, në këtë kontest Komuna e Drenasit në bashkëbisedim më përfaqësuesin e kompanisë së lartë përmendur, kanë rënë dakord për një marrëveshje bashkëpunimi, si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo marrëveshje ka për qëllim që të ndahën njezetë e dy bursa për studentët e Komunës së Drenasit, të shprehur më vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim, më qëllim të ndihmesës së studentëve për t’ia lehtësuar kryrjen e studimeve.

Neni 2

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Kompanisë

1. Kompania e merrë për obligim që në bazë të kriterve të konkursit të datës 20.10.2021 për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Drenasit, do ti ndaj 22 (njezetë e dy) bursa për studentët e Komunës së Drenasit,
2. Kompania për një student do ta financoj shumën prej 500 (pësqind) euro, shuma e financuar në total për njezetë e dy studentë është 11,000.00 € (Njëmbdhjetë mijë euro).
3. Bursat do ti ndahën studentëve nga Kompania për vitin akademik 2021/2022.
4. Përmes këtyre bursave Kompania synon jo vetëm që studentët e Komunës tonë ti ndihmoj në aspektin financiar por edhe stimuloj në kryrjen e studimeve.

Neni 3
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komunës së Drenasit

1. Përpilimin e një liste prej studenteve të Komunës së Drenasit, që i kanë plotësuar kriteret e konkursit të datës 20.10.2021 për ndarjen e bursave për studentet e Komunës së Drenasit.
2. Të sigurojë kopjet e llogarive bankare dhe letërnjoftimeve për 22 (njetzetë e dy) studentët dhe do ti dorëzohen fizikisht Kompanisë “ALTRADE CENTER” së bashku me një listë, ku në atë listë do të specifikohen: Emri, Emri i Prindit, Mbiemri, Fakulteti, viti i Studimeve, në bazë të konkursit për ndarjen e bursave.
3. Komuna e Drenasit ka për obligim që Kompanisë “AL TRADE CENTER” t’i siguroj çdo dokumentacion tjetër që lidhet me numrin e studentëve të lartëcekur për ndarjen e bursave, nr. e telefonave të këtyre studenteve dhe çdo ndihmë tjetër për realizimin e pagesave të këtyre studenteve.
4. Komuna e Drenasit do të jetë shumë mirënjohës donatorit “AL TRADE CENTER” me seli në Drenas për donacionin e dhënë për studentet e Komunës së Drenasit.

Neni 4
Zbatimi i Marrëveshjes

1. Palët e kësaj marrëveshje vendosin që zbatimi i saj të koordinohet ndërmjet një përfaqësuesi të caktuar nga Komuna dhe një përfqësuesi të caktuar nga Kompania “AL TRADE CENTER” në Drenas.
2. Palët e kësaj marrëveshje do të mbajnë kontakte për zbatimin e kësaj marrëveshje, dhe do të njoftojnë njëra-tjetrën me çdo kërkesë, vërejtje, sugjerim a propozim që ka të bëjë me realizimin e kësaj marrëveshje.
3. Nëse Palët vlerësojnë se marrëveshja duhet ndryshohet apo plotësohet nëpërmjet negociatave dhe miratimit me shkrim të ndërsjellë të Palëve.

Neni 5
Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.
2. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë njëvjeçare.

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

(nënshkrimi dhe vula)



Për Kompaninë “AL TRADE CENTER”

Sokol Gashani, Drejtor

(nënshkrimi dhe vula)